



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.142, Datë 24.04.2023

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ECO-ELB” SH.A. NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
I PËRPUNIMIT TË MBETJEVE URBANE, QARKU ELBASAN, ME KAPACITET
TË INSTALUAR 2850 KW**

Në mbështetje të neneve 16, dhe 37 pika 2, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1, gërma “a” dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 137/11 prot., datë 20.04.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “ECO - ELB” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 118, datë 04.04.2023, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licences së shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 05.04.2023 dhe 06.04.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 14.04.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 137/7 prot., datë 07.04.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë dhe ka vënë në dijeni Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për fillimin e procedurës si më sipër.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për rinovimin licencës në veprimtarinë e

prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitohet në ERE: dokumentacionin e kërkuar nga neni 16 “Rinovimi i licencës”; formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur); si dhe të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A të Rregullores dhe nuk rezulton debitore ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga shoqëria “ECO - ELB” sh.a. rezulton se ai është plotësuar si vijon:
 - Neni 16 Rinovimi i licencës, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por afati i kontratës së qirasë, të nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (Qiradhënësi) dhe shoqërisë “ECO – ELB” sh.a. (Qiramarrësi) është deri më 27.03.2024. Në këto rrethana, ERE do të rinovojë licencën e shoqërisë në mbështetje të afateve të kësaj kontrate, për këtë arsye vlefshmëria e licencës do të jetë deri më 27.03.2024.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “ECO- ELB” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW, deri më 27.03.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI